



# Tregu i Fundvitit

*Rregullat e aplikimit për periudhën 2019/20*

## QËLLIMI

**Tregu i Fundvitit**, aktivitet i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës në prag të festave të fundvitit, ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla. Këto biznese do të kenë rastin të bëjnë shitjen e produkteve ushqimore, suvenireve dhe kartolinave punëdore në shtëpizat e drurit, të cilat do të vendosen në sheshin “Zahir Pajaziti”.

## RREGULLAT E TREGUT TË FUNDVITIT

### **1) Vendi dhe orari i punës**

Hapja e Tregut të Fundvitit do të bëhet më 1 dhjetor 2019, në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe sheshin “Skënderbeu”, dhe do të qëndrojë i hapur deri në fillim të muajit janar, 2020. Gjatë kësaj periudhe bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën, duke filluar prej orës 10:00 deri në orën 23:00.

### **2) Kriteret e aplikimit**

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Tregun e Fundvitit, do të bëhet nga një komision i Komunës së Prishtinës. Numri i shtëpizave do të jetë i kufizuar. Plotësimi i kriterëve në vazhdim do të jetë përcaktues në përzgjedhjen e bizneseve sa më adekuate:

- Bizneset do të aplikojnë për produkte ushqimore, si dhe kartolina, suvenire dhe dhurata punëdore me motive të festave të fundvitit;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës, me adresë operimi në komunën e Prishtinës;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të pajisura me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Tregun e Fundvitit;
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikuj.

### **3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë:**



- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore;
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative në fushën e kulinarisë dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të festave të fundvitit;
- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit.

#### **4) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës**

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të Tregut të Fundvitit, janë përcaktuar duke u bazuar në Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa përcaktohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, bizneset e selektuara do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej 10.00 € për m<sup>2</sup>, për periudhën e shfrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

#### **5) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë**

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre. Për të qenë ky bashkëpunim sa më i mirë, Komuna e Prishtinës gjatë periudhës sa do të jetë Tregu i Fundvitit, ndalon rreptësishtë aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda zonave të zhvillimit të tregut: abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurruese, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave;
- Të gjitha bizneset e përzgjedhura obligohen t'i marrin përsipër shpenzimet e rrymës elektrike, si dhe shpenzimet e sigurisë për periudhën e shfrytëzimit të shtëpizave;
- Të gjitha bizneset e përzgjedhura obligohen që të bashkëpunojnë me kompanitë e sektorit privat, që e mbështesin Komunën e Prishtinës në mbulimin e shpenzimeve shtesë, si: skenë, zërim, ndriçim, LED, angazhim të artistëve që do të performojnë në "PRiteNshesh", si dhe shpenzimet shtesë;
- Të gjitha bizneset e përzgjedhura obligohen që pas përfundimit të orarit të punës, ta pastrojnë shtëpizën në shfrytëzim dhe hapësirën rreth saj;
- Muzika dhe performancat në hapësirat e Tregut të Fundvitit gjatë gjithë kësaj periudhe, do të jetë e organizuar dhe e përbashkët. Muzika dhe performancat individuale të bizneseve në shtëpizat e tyre janë të ndaluara rreptësishtë.



## **6) VËREJTJE**

Komuna e Prishtinës nuk merr përsipër përgjegjësinë dhe obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës rreth arkës fiskale, andaj obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që kuponët fiskal t'i vërtetojnë (vulosin) në Administratën Tatimore të Kosovës.

Nëse nuk zbatohet Kodi i mirësjelljes i sqaruar më lart, bizneset do të sanksionohen me marrjen e lejes për shtëpizë, do të futen në listën e zezë të Komunës së Prishtinës dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzimin e saj.